

Me rastin e botimit të antologjisë së poezisë shqiptare: “Lightning from the Depths: an Anthology of Albanian Poetry.” Edited and translated from the Albanian by Robert Elsie and Janice Mathie-Heck. Writings from an Unbound Europe. ISBN 978-0-8101-2463-9 (Northwestern University Press, Evanston, Illinois 2008) xxxi + 293 pp.

Falemnderit për ardhjen tuaj dhe për interesin tuaj. Desha të them veç dy fjalë të shkurtra për antologjinë e re.

Kjo, në fakt, është antologjia e katërt e poezisë shqiptare në përkthim që kam botuar. Antologjia e parë *Einem Adler gleich: Anthologie albanischer Lyrik vom 16. Jahrhundert bis zur Gegenwart* (Si një shqiponjë: antologjia e lirikës shqiptare nga shekulli 16 deri me sot), u botua gjermanisht në vitin 1988. Ajo u financua nga Instituti gjerman për Marrëdhënie me Jashtë. Antologjia e dytë, *An Elusive Eagle Soars: Anthology of Modern Albanian Poetry* (Një Shqiponjë e arratisur fluturon: antologjia e poezisë bashkëkohore shqiptare), u botua anglisht në Londër në vitin 1993 në kuadrin e Veprave Përfaqësuese të UNESCO-s. Antologjia e tretë, gjithashtu anglisht, *Contemporary Verse from Albania* (Poezia bashkëkohore nga Shqipëria) u botua në internet në vitin 2006 në faqen: *Transcript, European Internet Review of Books and Writing*, Vol. 24 (www.transcript-review.org). Kjo antologji doli paralelisht edhe gjermanisht nga Hans-Joachim Lanksch edhe frëngjisht nga Ardian Marashi.

Megjithatë, gjithmonë kam patur ëndërr të botoj një antologji të plotë të poezisë shqiptare anglisht, dhe më në fund, pas shumë peripecive, ajo doli në Shtetet e Bashkuara, dhe, për fatin tonë, prej një botuesi prestigjioz, Northwestern University Press.

Kolegu gjerman, Hans-Joachim Lanksch, më tha një herë: “Të hartosh një antologji të poezisë shqipe është si të kalosh një fushë me mina.” Di bile për një antologji tjetër gjermanisht të poezisë shqiptare botuar në vitin 2003, ku autori shqiptar i asaj vepre u kërcënua nga një poet për vdekje! Kaq seriozisht e marrin shqiptarët poezinë e tyre!

Kjo antologji, me titullin *Lightning from the Depths*, titulli i frymëzuar nga vargu i poezisë *Mëngjes* të Lasgush Poradecit: “Se fund’ i ujit vetëtit,” përfshin rreth 50 autorë dhe rreth 250 poezi dhe është fryti i shumë viteve të përgatitjes. Sipas mendimit tim, është antologjia e poezisë shqipe më e arritur, dhe kjo për disa arsye. Së pari, ajo përfshin gjithë gamën e poezisë shqiptare nga aspekti kohor, pra nga fillesat e lirikës shqipe deri në poezinë bashkëkohore shqiptare. Së dyti, kemi arritur një cilësi shumë të lartë letrare, dhe kjo në një masë të dukshme falë bashkëpunimit të poeteshës kanadeze Janice Mathie-Heck, e cila për fat të keq nuk mund të jetë pranë nesh sot.

Për çdo antologji letrare flitet shumë për çështjen e përfshirjes apo të mospërfshirjes. Unë kam ndjekur dy parime për këtë antologji: së pari, duke qenë se letërsia shqiptare njihet shumë pak në botën anglishtfolëse, doja pa tjetër të përfshija poetët dhe emrat më të njohur nga letërsia shqipe. Së dyti, dhe kjo është po aq e rëndësishme, është cilësia e poezisë përkatëse në përkthim. Një poemë mund të jetë jashtëzakonisht e bukur shqip, por nëse nuk del mirë në përkthim, atëherë veç i prish punë autorit. Dua të theksoj këtu se ka shumë poetë të shkëlqyer, por që nuk përkthehen mirë. Kjo është një arsye pse disa poetë bashkëkohorë të njohur nuk janë përfshirë në këtë antologji.

Si përfundim, kjo antologji është sigurisht një hap i madh në njohjen e letërsisë shqiptare në

botën anglishtfolëse, dhe shpresoj se do të ketë shumë hapa të mëtejshëm në të ardhmen, sepse poezia është pasqyra e shpirtit të një populli, dhe shqiptarët, të shtypur dhe të izoluar në të kaluarën, kanë shumë për të thënë.

Falemnderit.

Robert Elsie
Tiranë, 5 dhjetor 2008